



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit

Zyra e Kryetarit
01-Nr. 020-55409 dt. 23/12 2020



Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.110-6904 të datës 24.09.2008, e në mbështetje të nenit 10 të Rregullores 12-Nr.400/01-51554 dt. 26.11.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, me këtë përbërje:

1.1 Besart Bajrami, Kryesues

1.2 Haki Bekolli, Anëtar

1.3 Fadil Tahiri, Anëtar

2. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit është që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, se a i permbushin kushtet dhe kriteret konform kësaj rregulloreje për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe t'i rekomandojnë Kryetarit të Komunës për nënshkrimin e kontratës.

3. Mandati i komisionit është dy (2) vite.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës
Ranga Uadrovc